

KËRKIME GJUHËSORE

Ilirian MARTIRI

PROBLEMATIKA TË SINONIMISË SINTAKSORE MES SINTAGMAVE FOLJORE DHE ATYRE ME EMRA VEPRIMI NË GJUHËN SHQIPE

Në këtë kumtesë do të trajtohen probleme gjuhësore të sinonimisë sintaksore, që vihen re gjatë procesit komunikativ në ligjërimin e shkruar. Studiues të ndryshëm i kanë trajtuar këto probleme nisur nga aspekti i respektimit ose jo të normës standarde në tekstet përkatëse, duke e vënë theksin jo vetëm në cilësitë drejtshkrimore, por edhe në dukuritë sociolinguistike të konstatuara. Arsyeja e ndërmarrjes së një studimi të tillë qëndron në faktin se, prej shumë kohësh, edhe në hapësirat shqiptare vazhdon të jetë e hapur çështja e një komunikimi cilësor në të gjitha nivelet shoqërore shqiptare. Prej shumë kohësh flitet për cilësinë e këtij komunikimi. Një nga çështjet më të diskutueshme vazhdon të mbetet nëse në një përdorim të caktuar gjuhësor do të zënë vend sintagma foljore apo sintagma me emra veprimi të prejardhur nga foljet përkatëse. Cila do të ishte zgjedhja e duhur? Cili do të ishte raporti më i pranueshëm që do të rezultonte nga zgjedhje të tilla në përputhje me synimet komunikative në vende, kohë dhe situata ligjërimore nga më të larmishmet?

Në këtë perspektivë, të gjitha manualët dhe botimet e tjera shkollore apo propaganduese, synojnë që përdoruesi i gjuhës shqipe, nëpërmjet komunikimit të tij, të arrijë të jetë në pajtim me logjikën e përdorimit gjuhësor¹, si dhe me normat gjuhësore të pranuara shoqërisht. Për një komunikim sa më të efektshëm, atij i nevojitet saktësi në shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave. Gjithmonë sipas këtyre manualeve, për ta arritur një komunikim të tillë cilësor, këtij përdoruesi i nevojitet gjithashtu të mos bëhet i mërzitshëm kur flet dhe kur shkruan, duke shmangur përsëritjet dhe duke pasuruar fjalorin e tij. Kështu, falë mekanizmit gjuhësor, mes gjithë alternativave sinonimike të shprehësisë, për këtë individ ekziston mundësia për të zgjedhur në çdo rast fjalën e duhur në të gjitha ligjërimet, në të gjitha stilet, në të gjitha situatat ligjërimore, duke pasur parasysh të gjitha mundësitë e fjalëve me të gjitha vlerat e tyre². Prandaj dhe problemi vazhdon të shtrihet jo thjesht në planin arsimor, por mbi të gjitha në atë të përvojave jetësore.

Pavarësisht nga të gjitha diskutimet në dinamikën shkencore gjuhësore, për të gjitha kërkesat pedagogjike e profesionale dhe administrative e shtetërore, kuadri i përgjithshëm, megjithë dinamicitetin e tij, vazhdon të mbetet siç e parashtronte vite më parë Mahir Domi, kur shkruante se “procesi i intelektualizimit të mëtijshëm të gjuhës letrare u është përgjigjur kërkesave gjithnjë e më të mëdha të zhvillimit të shpejtë e të gjithanshëm të shoqërisë..., ka

¹ Lyons, J. *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Sh.B. “Dituria”, Tiranë, 2001, f. 415.

² *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

rritur në përmasa të mëdha fuqinë e mundësitë shprehëse të saj”³. Në mënyrë të veçantë, ky studiues e vuri theksin në brendësi të mekanizmit gjuhësor, duke u shprehur se ky proces “në sintaksë ka qenë veçanërisht i ndjeshëm, duke e bërë shqipen e sotme letrare një gjuhë kulture të zhvilluar”⁴. Për më tepër, këtij procesi “i takojnë mjaft dukuri konkrete të zhvillimit të strukturës së gjuhës sonë, pasurimi i kësaj me aq mjete e mënyra të reja, përsosja e mëtejshme e shumë mjeteve ekzistuese...”⁵.

Në të njëjtën linjë vjen edhe mendimi i shprehur nga Seit Mansaku, i cili vë në dukje se “zhvillimi në gjuhë shprehet nga ana sasiore në shtimin e mjeteve të ndryshme shprehëse”⁶. Kështu, sërish sipas tij, “kjo rritje sasiore çon domosdo dhe në një rritje cilësore, në përsosjen e sistemit sintaksor të gjuhës”⁷. Duke e sqaruar më tej konceptin e tij, studiuesi Mansaku thekson se rritja nga ana cilësore gjen shprehje në forcimin e karakterit sistemor të gjuhës, në organizimin racional, në përdorimin sa më ekonomik e të efektshëm të këtyre mjeteve, pra, në përkryerjen e sistemit të saj⁸. Mendimi i tij gjen mbështetje edhe nga hartuesit e “Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të cilët, gjatë trajtimit të çështjeve që lidhen posaçërisht me sinoniminë në gjuhën shqipe, vënë në dukje se “jo thjesht nga pikëpamja sasiore, por sidomos nga pikëpamja cilësore, sinonimia është shprehje e pasurisë së gjuhës”⁹. Por, nga ana tjetër, në kuadrin e përgjithshëm të teorisë gjuhësore, John Lyons, duke iu referuar një gjuhëtari tjetër, Ullmann, vë në dukje se është “një e vërtetë e njohur që sinonimia tërësore ndeshet shumë rrallë, është një luks, që gjuha zor se ia lejon vetes”¹⁰.

Në këto kushte, vetë përvoja e kultivuar dikton, sipas Mahir Domit, se “sinonimia sintaksore kërkon që, në serinë e sinonimeve, të zgjidhet mjete sintaksor më i përshtatshëm për rastin e dhënë, që lejon të shprehet më mirë e më saktë mendimi, ndjenja”¹¹. Si rezultat i ushtrimit të përvojës jetësore të përdoruesit të gjuhës shqipe, mes njësive sinonimike të njohura prej tij, “krahasimi mund të bëhet në aspekte të ndryshme (cilësor, sasior etj.), në plane të ndryshme barazie e mosbarazie, ...”¹². Dhe kjo sepse nëpërmjet krahasimit në çast të këtyre njësive

³ Domi, M. “Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme”. *Studime filologjike*, nr. 4, 1984, Tiranë, f. 59-68.

⁴ Domi, M. po aty.

⁵ Domi, M. po aty.

⁶ Mansaku, S. “Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare”, *Gjuha jonë*, nr. 1, 1985, Tiranë, f. 132.

⁷ Mansaku, S. po aty, f. 133.

⁸ Mansaku, S. po aty, f. 132.

⁹ *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005, f. 12.

¹⁰ Lyons, J. po aty, f. 412.

¹¹ Domi, M. “Çështje të kulturës së gjuhës në fushën e sintaksës”. *Gjuha jonë*, nr. 3, 1983, Tiranë, f. 19.

¹² *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 605.

PROBLEMATIKA TË SINONIMISË SINTAKSORE MES SINTAGMAVE
FOLJORE DHE ATYRE ME EMRA VEPRIMI NË GJUHËN SHQIPE

për të zgjedhur njësinë e duhur “mund të tregohet nëse... kemi të bëjmë me dy dukuri identike, të ngjashme ose të ndryshme...”¹³. Kështu, vështirësia dhe sfida e këtij përdoruesi për zgjedhjen më cilësore bazohet në faktin e ekzistencës së njërive sintaksore me kuptim të njëjtë a të afërt¹⁴. Cila prej tyre do të jetë njësia e duhur, shprehësja e vërtetë e mendimit? Kjo pyetje nuk është e rastit, shumë njerëz mundohen së tepërmi për të kryer zgjedhjen e saktë në formulimin e tyre gjuhësor.

Natyrisht, menaxhimi i cilësisë ka dhe koston e vet. Siç thotë edhe një fjalë e urtë, përvoja të mëson ngadalë dhe me koston e gabimeve. E gjitha kjo për arsien e thjeshtë, sipas së cilës “as teorikisht, as praktikisht nuk mund të vendoset një kufi aq i prerë ndërmjet fjalëve sinonimike e gatisinonimike”¹⁵. Ky problem ndërlikohet më tej kur shtrohet çështja e cilësisë komunikative në përputhje me normën standarde të vendosur për nevojat e komunikimit në nivele të larta shoqërore, profesionale shkencore, administrative e shtetërore e, në këtë perspektivë, me normën stilistike, që është, siç e përcakton dhe Xhevat Lloshi, “parapëlqimi në një kontekst a në një sferë i njërit prej varianteve, që mund të jenë sinonime”¹⁶.

Vërtet janë sinonime fjalët me kuptim të njëjtë, por ato “mund të dallohen nga elemente semantike të rrafshit gramatikor, si shkalla e cilësisë, intensiteti i veprimit etj.”¹⁷. Sipas Xhevat Lloshit, dallimi i tyre bëhet i mundur nga një tipar semantik. Kështu, afrimi i sinonimeve “në një kontekst (vendosja në sintagmë e elementeve të një paradigme kuptimore) e vë në pah anën që shënon ky tipar dhe që shfaqet me intensitet të ndryshëm”¹⁸. Në këtë mënyrë, “dalohen sinonimet ndërmjet tyre... nga... ndryshimi i shkallës së cilësimit”¹⁹. Për më tepër, “përparësi mund t’i jepet si njëres, ashtu edhe tjetres fjalë, sipas cilësive të ndryshme emotive ose shoqëruese”²⁰. Vetë përvoja e përditshme tregon se në situata të ndryshme jetësore komunikative “mund të jetë fjala për të zgjedhur midis dy fjalësh të barasvlershme, për të provuar një sinonim, për të përdorur një sinonim, për të bërë një saktësim (...) për të dhënë një sqarim më të mirë të nocionit, për larmi”²¹, për të tipizuar më mirë vetat, rrethanat, mjediset²².

Duke e ndjekur çështjen e sinonimisë në kuadrin e paralelizmit sintaksor, në tekstin akademik të Sintaksës së gjuhës shqipe vihet në dukje se ndryshimi kuptimor e stilistik del më mirë në dukje me përqasjen e dy ndërtimeve

¹³ Gramatika... II, Sintaksa. po aty.

¹⁴ Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. SHBLU, Tiranë, 2002, f. 141-142.

¹⁵ Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, po aty. f. 15.

¹⁶ Lloshi, Xh. *Stilistika dhe pragmatika*, ShB. “Toena”, Tiranë, 1999, f. 34.

¹⁷ Fjalor sinonimik... po aty, f. 15.

¹⁸ Lloshi, Xh. po aty, f. 135.

¹⁹ Thomai, J. po aty, f. 139.

²⁰ Lyons, J. po aty, f. 413.

²¹ Gramatika... II, Sintaksa, po aty, f. 304.

²² Thomai, J. po aty, f. 143.

sintaksore²³. Në pajtim me këtë parashtrim, vijojnë disa shembuj nga letërsia shqipe e viteve të fundit, si dhe transformimet e tyre pas zëvendësimit të një sintagme emërore me emër veprimi me sintagmë foljore, e cila përmban foljen prej së cilës emri përkatës e ka prejardhjen. Paraqiten së pari vlerat semantike të sintagmave emërore me emra veprimi:

(1) *Sipas tij, s'ishte e mundur që në qytetet e tjera zbuloheshin çdo ditë rrjete për tregtimin e prostitutave në Itali, e këtu, në B, vajzat të mos goxonin të rrinin me të dashurin në kafene.*

I.Kadare, "Lulet e ftohta të marsit", v. 2001, f. 42.

(2) *Atë – herë edhe të bëhetë një trazim në Sinisit të Ballkanit, edhe të bjer' e të humbasë Tyrqia, Shqipëria qëndron më vetëhe të – saj; edhe nonjë njeri nukë dotë mendohetë ç'dotë bëhetë Shqipëria, as njeri dotë kuxonjë të vërë ndër mënd rrëmbimn' e një cope të Shqipërisë.*

S.Frashëri, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të jetë", v. 1944, f. 65.

(3) - *Flitet se Bamkës do t'i jepet e drejta e botimit vetëm atëherë kur të jepet e drejta e mbajtjes së lopës, deles, patës dhe gjelit të detit ... – foli berberi.*

D.Agolli, "Arka e djallit", v. 1997, f. 298.

(4) *Po xhonturqit bëjnë gjithnjë lajthimin e çuditshim të kuptojnë çdo punë përgjysmë.*

F. Noli, "Vepra 2" (1905-1925) v. 1986, f. 380.

Në këto sintagma dukuritë supozohen si të përfunduara në plotësinë e tyre, brenda një intervali kohor sa më të shkurtër që të jetë e mundur, madje në rastet kur diçka e tillë nuk arrihet, procesi dhe shpenzimi i energjive për të arritur në fitimin e një dukurie të tillë, sipas kuptimeve që mund t'i jepen tekstit, nuk kanë më rëndësi. Gjithashtu, dukuritë paraqiten si të dhëna absolute me gjithçka që ngërthejnë në vetvete, tek individët në tërësi e në raporte me të tjerët. Emrat më –im kanë përbërës kuptimorë nga pikëpamja filozofike, psikologjike, shoqërore dhe morale. Në to spikasin më tepër elemente të ligjërimit të shkruar, libror, por ndërthuren mes tyre edhe elemente të ligjërimit bisedor, në funksion të realizimit të një shprehësie sa më të gjerë. Shprehja e kuptimit të rezultatit në to paraqitet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Emrat më –im e paraqesin dukurinë në një trajtë sintetike, si një koncentrim përvojash me të njëjtin thelb të përbashkët, të njohur shoqërisht në çdo vend e kohë, aq më tepër kur ata paraqiten në trajtë termash, si shprehje të kuptimeve tekniko-profesionale në fusha të caktuara, si shprehje të kompetencës profesionale në to. Kjo vlen jo vetëm për ligjësinë tekniko-shkencore, por edhe për aspektet ligjore shoqërore, nga pikëpamja zyrtare, si shprehje e mendimit dhe e organizimit shoqëror e shtetëror, larg tendencave të ndryshme emocionale të psikologjisë njerëzore, në një sfond sa më të plotë të mundshëm të rrjedhës së ngjarjeve sipas një radhe të caktuar dhe në përputhje të plotë me ligjësinë natyrore, duke arritur në një përmbyllje sa më të shpejtë mundësisht të kësaj radhe të rrjedhës së ngjarjeve.

²³ Gramatika... II, Sintaksa, po aty, f. 382.

PROBLEMATIKA TË SINONIMISË SINTAKSORE MES SINTAGMAVE
FOLJORE DHE ATYRE ME EMRA VEPRIMI NË GJUHËN SHQIPE

Ndërkohë, duke kaluar në modelet e tyre të transformuara si pasojë e zëvendësimit të sintagmës emërore të nënvizuar me sintagmën foljore përkatëse, kemi:

(1*)... rrjete që **tregtonin** prostituta në Itali ...

(2*)... të vërë ndër mënd që **të rrëmbejë** një copë të Shqipërisë.

(3*)... do t'i jepet e drejta që **të botojë** vetëm ...

(4*)Po xhonturqit **lajthitin** gjithnjë në mënyrë të çuditshme, ...

Në parashtrime të tilla shkohet drejt shuarjes së tipareve stilistike të konstatuara në modelet origjinale. Vihet re tendenca drejt një pranie tiparesh karakteristike për ligjërimin e folur, edhe pse mund të jenë pjesë e një materiali të shkruar nga me tipare karakteristike letraro-artistike. Kemi të bëjmë me një karakter më analitik në shprehësi. Veprimi paraqitet më i ngadalshëm dhe, si rrjedhim, më i perceptueshëm në rrjedhën kohore, duke mos u vendosur në dinamikën absolute të tij, si në origjinalet me ndërtimet emërore. Ndërtimet foljore arrijnë të bëjnë të mundur zbulimin e ndonjë elementi të caktuar semantik, që në ndërtimet emërore më -im thuajse nuk bie fare në sy. Por në raste të tjera, modelet e transformimit përmbajnë rrezikun e shmangieve të konsiderueshme nga stili origjinal i autorit, sidomos në rastet kur ndodhin ndryshime në skemën e përgjithshme strukturore të periudhave, pavarësisht nga fakti se procesi i transformimit zbatohet vetëm në njërën prej fjalive të një periudhe të caktuar.

Natyrisht, edhe këto të dhëna vlejnë për t'u pasur parasysh gjatë procesit të menaxhimit komunikativ, në përputhje me situatat jetësore ku është i nevojshëm përdorimi përkatës i tyre. Vetë gjuha zotëron forma analitike të shprehjes së të njëjtit kuptim, ...me mjete sintaksore, sintagmatike e frazeologjike²⁴, që i bëjnë të mundur përdoruesit të saj të bëjë zgjedhjen e duhur në pajtim me synimet e tij komunikative drejt arritjes së qëllimit, duke qenë një menaxhues i drejtë i komunikimit të tij.

²⁴ Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, po aty. f. 21.